

## **SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e Filmit dhe Medias për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Dokumentar për 20-vjetorin e AMA-s”.

### **TERMAT E REFERENCËS**

#### **Objektivi**

Si punë e parë e këtij lloji në 20 vite eksperiencë si institucion, AMA kërkon të prezantojë nëpërmjet dokumentarit, historinë e tij, por edhe analizën e terrenit të krijimit dhe zhvillimit të autoritetit, përgjatë këtyre 20 viteve në Shqipëri.

Kohëzgjatja e dokumentarit duhet të jetë 30 – 45 min.

#### **Detyrat**

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Realizimi i skenarit;
- Përcaktimi i fondit limit;
- Ndjekja e procedurës së prokurimit;
- Ndjekja e realizimit të kontratës së shërbimit për prodhimin e dokumentarit.

#### **Periudha e zbatimit të detyrave:**

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri në realizimin/marrjen në dorëzim të dokumentarit.

#### **Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm**

1. Të zotërojë diplomën e bachelor në Film dhe Media. Kualifikimet në fushën e Regjisë, Skenarit ose Produksionit do të përbëjnë avantazh;
2. Të jetë i/e përgatitur të parashikojë format e ndryshme të produksionit në terren dhe në kohë;
3. Të ketë eksperiencë me organizata kombëtare në fushën e filmit, televizionit, marketingut dhe organizimit të eventeve kombëtare;
4. Të ketë ushtruar aftësitë prodhuese në punë të ngjashme;
5. Të jetë shtetas/e shqiptar;

#### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:**

1. Diploma e Bachelor në Film dhe Media;
2. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme në fushën e filmit, televizionit, marketingut dhe organizimit të eventeve kombëtare;
3. Jetëshkrimi;
4. Kopje ID/Pasaportë;

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

1. Diploma e shkollës së lartë;

30 pikë

- |   |         |
|---|---------|
| 2. Dokumentacioni për punë të ngjashme; | 60 pikë |
| 3. Jetëshkrimi;                         | 10 pikë |

**Produktet dhe materialet**

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara, në AMA.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

**Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë**

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 28 SHKURT 2019**